



BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

## PROGRAMI I EDUKIMIT PËR FËMIJËT 6-18 MUAJ MUAJI TETOR



PËR STAFIN EDUKATOR TË ÇERDHEVE PUBLIKE TË TIRANËS

 Fëmijët e Tiranës

<http://femijetetiranes.al/>

 femijet\_e\_tiranes

## “Karakteristika të Stinës së Vjeshtës”



### Çfarë duhet të dimë për Vjeshtën?

- \* Vjeshta është një nga katër stinët e bukura të vitit ku natyra merr një pamje përrallore.
- \* Karakteristikë e stinës së vjeshtës është zverdhja e gjetheve dhe rënia e tyre në tokë.
- \* Në vjeshtë, dita nis të bëhet më e shkurtër dhe nata vjen më shpejt.
- \* Në vjeshtë, shumë kafshë fillojnë të përgatiten për stinën e dimrit duke mbledhur dhe ruajtur ushqimin nëpër fole dhe strofka.

**Muaji Tetor – Tema Mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës**  
**Grupi Latant: 6-18 muaj**

- \* **Java I:** Karakteristikat e përgjithshme të stinës së vjeshtës
- \* **Java II:** Njohja me elementët kryesorë të stinës së vjeshtës
- \* **Java III:** Njohja e frutave dhe perimeve të stinës së vjeshtës
- \* **Java IV:** Veshja në vjeshtë



**Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës**


<b>Temat Javore</b>	<b>Qëllimi</b>	<b>Koha e realizimit</b>
Karakteristika të përgjithshme të stinës	Njohja me elementët kryesorë të stinës si: moti në vjeshtë, shiu, era.	Java I
Njohja me elementët kryesorë të stinës	Njohja me disa elementë kryesorë si: dielli, qielli, shiu përmes punimeve të vizatimit.	Java II
Njohja e frutave dhe perimeve të stinës	Njohja e frutave, perimeve përmes demonstrimit të përgatitjes së ushqimeve.	Java III
Veshja në vjeshtë	Si vishemi në vjeshtë? Ndryshimi nga veshjet e lehta të verës tek ato më të ngrohtat.	Java IV
<b>Shënim:</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>* Stafi edukator duhet ta realizojë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim asimilimin sa më thjeshtë të njohurive nga fëmijët.</li> <li>* Stafi edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre dhe diskutimin me fëmijët në shtëpi.</li> </ul>		

## Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës




### Tema e javës: Njohja me Karakteristika të Përgjithshme të Stinës



Java I	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p><b>Karakteristikat kryesore të stinës së vjeshtës</b></p> 	<p><b>Lojë ndijore me gjethe. (aktivitet në oborr ose grup)</b> Vendosi në disa kosha ose kuti objekte që kanë përbërje të ndryshme psh: bar, gjethe, ujë, gurë, pambuk etj. Ulini fëmijët pranë koshave në mënyrë që të prekin/ eksplorojnë objektet në to.</p> <p><b>Bisedë:</b> Gjatë lojës emërtoni objektet që fëmija prek, përcaktoni cilësitë e tyre përshembull: e butë, e fortë, e ftohtë etj. Tregoni me gisht qiellin, retë, diellin, pemët dhe emërtojini ato.</p> <p><b>Këngë lëvizore:</b> (Me dëshirë)</p> <p><b>Loja me top.</b> Hedhim dhe nxjerrim topat nga koshi.</p>	Manuali i Vjershave Mjete didaktike, kosha/kuti, gjethe etj.
E Martë	<p><b>Ngjyrat e vjeshtës</b></p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Ylli i vogël”.</p> <p><b>Këngë lëvizore.</b></p> <p>*(Mund të zgjithni një ose dy nga lojrat e mëposhtme)</p> <p><b>Loja:</b> Futja e kupave te njëra-tjetra. (Edukatorja tregon dhe emërton ngjyrat karakteristike të stinës).</p> <p><b>Loja me top:</b> Jepini fëmijëve nga një top të vogël dhe kërkojuni t’ua pasojnë atë.</p> <p><b>Lojë:</b> “Pikturimi me gishta – mbi ngjyrat e vjeshtës</p>	Manuali i Vjershave
E Mërkurë	<p><b>Lojra dhe aktivitete.</b></p>	<p><b>Lojë:</b> Loja e tunelit.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Xhepi im i vogël”.</p>	Manuali i Vjershave

		<p><b>Përrallë:</b> “Ciu ciu kërkon mamin (libra zanor)”.</p> <p><b>Aktivitet:</b> Hedhim lodrat në kosh. Kërkojuni fëmijëve të mbledhin dhe hedhin lodrat në kosh.</p>	
<b>E Enjte</b>	<p><b>Pemët dhe gjethet në vjeshtë</b></p> 	<p><b>Lojë ndijore me gjethe. (aktivitet në oborr/grup)</b> Ulini fëmijët mbi gjethe, rërë etj. Lejojini fëmijët të prekin/ luajnë me gjethet.</p> <p><b>Bisedë:</b> Gjatë lojës në oborr ose në grup emërtoni ngjyrat e gjetheve duke ia treguar ato fëmijës për shembull: e kuqe, e verdhë, e gjelbër etj.</p> <p><b>Këngë:</b> “Rosat notojnë në liqen”.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Ylli i vogël”.</p> <p><b>Këngë lëvizore 2.</b></p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Materiale: gjethe, rërë.</p>
<b>E Premte</b>	<b>Aktivitet motorik.</b>	<p><b>Loja:</b> Pasim i topit.</p> <p><b>Loja:</b> Vendosja e rathëve në kon.</p> <p><b>Lojë.</b> Lojë me kuba të madhësive të ndryshme (me zgjedhje).</p> <p><b>Përrallë me kafshë-</b> Ilustrim i figurave me karakteristikat e stinës(sipas librave që disponojnë në grup).</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Mjete didaktike, Libra.</p>

**Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës**  
**Tema e javës: Njohja me Elementët Kryesorë të Stinës**



Java II	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p style="text-align: center;"><b>Qielli &amp; Dielli në vjeshtë</b></p> 	<p><b>Aktivitet:</b> Me materiale të ndryshme si shkopinj pambuk, lapsa, fara/ makarona formoni në një letër/ karton diellin, retë, pikat e shiut.</p> <p><b>Demonstrim:</b> Edukatorja u tregon fëmijëve përmes punimeve që ka bërë paraprakisht në letër diellin, retë dhe shiun. Lejojini fëmijët të prekin punimet e krijuara më përpara nga ju.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Dielli”</p> <p><b>Loja:</b> Lodra me muzikë.</p> <p><b>Këngë lëvizore 1.</b></p>	Manuali i Vjershave Mjete didaktike.
E Martë	<p style="text-align: center;"><b>Ditë vjeshte me re dhe shi</b></p>	<p><b>Aktiviteti:</b> Paradë me veshje. Me mjete të riciklueshme krijoni veshje që na mbrojnë nga shiu. Vishini fëmijët me to. Lejojini fëmijët t’i prekin dhe t’i eksplorojnë veshjet e tyre të reja.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Dielli”</p> <p><b>Muzikë dhe këngë :</b> Fëmijët dëgjojnë dhe kërcëjnë muzikë për fëmijë.</p> <p><b>Loja:</b> Loja me fluskat e sapunit.</p>	Manuali i Vjershave Mjete, qese, letraetj.



<p><b>E Mërkurë</b></p>	<p><b>Ditë shiu.</b></p> 	<p><b>Improvizim</b> Një ditë me shi në çerdhe. Vishini fëmijët me mushama, çadra ose përdorni veshjet e krijuara një ditë më parë me mjete të riciklueshme.  <b>Këngë lëvizore.</b>  <b>Vjersha:</b> “Shiu”.  <b>Aktivitet :</b> Të pikturojmë me ujë  <b>Përrallë:</b> Përrallë e lirë (librat zanorë).</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i lojrave.</p>
<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Çadra ime.</b></p> 	<p><b>Kënga:</b> “ Rosat notojnë në liqen”.  <b>Vjersha:</b> “Kam një top”.  <b>Aktivitet:</b> Krijoni çadra prej letre ose me shkopinj me të cilat fëmijët mund të luajnë.  <b>Loja:</b> Libri i ngjyrave  <b>Loja:</b> Gjejmë objektin e fshehur. Tregojini fëmijës një objekt dhe më pas fshiheni atë poshtë një batanijeje ose çarçafi (sigurohuni që fëmijët t’ju shikojnë). Më pas pyesni: “Ku shkoi lodra?”. Vëreni nëse fëmijët e kërkojnë/gjejnë atë.  (Mund të zhvilloni të dyja ose një të njërën nga lojrat e mësipërme)*</p>	<p>Manuali i Vjershave Mjete Didaktike</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Imitojmë tingujt.</b></p>	<p><b>Aktiviteti:</b> Imitojmë tinguj të ndryshëm si psh: shiun “sh, sh,sh”; makinën; la, do, ta-ta, ma etj. Vëreni nëse fëmijët po ju imitojnë.  <b>Loja:</b> Lodra me muzik. (Imitojmë tingujt).  <b>Vjersha:</b> “Kam një top”. (improvizo duke marrë një top).  <b>Përrallë:</b> Përrallë e lirë (librat zanor).</p>	<p>Manuali i Vjershave</p>




## Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

### Tema e javës: Frutat dhe Perimet e Stinës



Java III	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<p>Njohja me frutat</p> 	<p><b>Aktiviteti:</b> Shijet e frutave. Krijoni një piknik të vogël me frutat e stinës. Mund të përdorni frutin që kanë fëmijët atë ditë në menu. Lejojini fëmijët ta prekin frutin kur ai është me lëkurë dhe i qëruar. Lejojini fëmijët të provojnë frutin. Emërtoni cilësitë e tij, për shëmbull: e ashpër, e butë, e ëmbël, e athët etj.</p> <p><b>Vjersha:</b> “Ngjyrat e mollës”</p> <p><b>Kënga:</b> “Një elefant po kolovitet”.</p> <p><b>Loja:</b> Lojë me lego (ndihmojini fëmijët të montojnë dhe çmontojnë dy ose më shumë lego).</p>	Manuali i Vjershave
E Martë	<p>Njohja me perimet</p> 	<p><b>Aktiviteti:</b> Krijoni një panair të vogël me perimet e stinës. Mund të përdorni perimet që kanë fëmijët atë ditë në menu. Lejojini fëmijët t’i prekin ato (ose lëkurat e perimeve të qëruara). Lejojini fëmijët të provojnë perimet. Emërtoni cilësitë e tyre, psh: e ashpër, e butë. Emërtoni ngjyrat e perimeve.</p> <p><b>Kënga:</b> “Një elefant po kolovitet”.</p> <p><b>Muzikë dhe këngë:</b> Fëmijët dëgjojnë dhe kërcëjnë muzikë për fëmijë.</p>	
E Mërkurë	<p>Brumi për të luajtur</p>	<p><b>Kënga:</b> “Një elefant po kolovitej”..</p> <p><b>Loja:</b> “Numërojmë biskotat/ Brumi për të luajtur</p>	Manuali i Lojrave Brum për të luajtur.





		<p><b>Loja:</b> Me fluskat e sapunit.</p> <p><b>Loja.</b> Lojra ndijore.</p>	
<b>E Enjte</b>	<p><b>Lojra sensore dhe motorike</b></p> 	<p><b>Loja 1:</b> Vendosja e kubave mbi njëri-tjetrin.</p> <p><b>Loja 2:</b> Kërcejmë në vend.</p> <p><b>Loja 3:</b> Luajmë me rërë dhe ujë. (Mund të zhvilloni disa ose njëren prej lojrave të mësipërme.)*</p> <p><b>Aktivitet:</b> Hedhim lodrat në kosh. Kërkojuni fëmijëve të mbledhin dhe hedhin lodrat në kosh.</p> <p><b>Vjersha:</b> “ Ngjyrat e mollës”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p>
<b>E Premte</b>	<p><b>Përsëritje e aktiviteteve të javës:</b></p>	<p><b>Aktivitet:</b> Eksplorojmë frutat dhe perimet e ditës. Lejojini fëmijën të prekë frutat, perime dhe ushqime të ndryshme si makarona, fasule. Emërtoni cilësitë e tyre.</p> <p><b>Vjersha:</b> “ Ngjyrat e mollës”.</p> <p><b>Loja:</b> Vendosja e kubave mbi njëri-tjetri.</p> <p><b>Muzikë dhe këngë:</b> Fëmijët dëgjojnë dhe kërcëjnë muzikë për fëmijë (me zgjedhje).</p>	<p>Manuali i Vjershave</p> <p>Manuali i Lojrave</p>

## Tema mujore: Karakteristikat e Stinës së Vjeshtës

### Tema e javës: Veshja në vjeshtë



Java IV	Rubrika	Aktivitetet	Mjetet e Punës
E Hënë	<b>Veshja e fëmijëve në vjeshtë</b> 	<b>Aktivitet:</b> Tregojini fëmijëve veshjet e tyre, emërtojini atë si bluzë, xhaketë, pantallona etj. Tregoni ngjyrat e veshjeve. <b>Loja:</b> Lojë me objekte që bëjnë zhurmë, muzikë etj. <b>Përrallë:</b> Përrallë (librat zanor). <b>Loja:</b> Lodra me muzik. Imitojmë tingujt.	Lodra, libra.
E Martë	<b>Veshja për vajzat</b>	<b>Aktivitet:</b> Demonstroni fëmijëve veshjet e vajzave, emërtojini ato, si bluzë, xhaketë, fundi, fustani etj. Tregoni ngjyrat e veshjeve. <b>Loja:</b> Loja me gazeta ( vendosni disa gazeta në tokë dhe lejojini fëmijët të ecin mbi to, t'i prekin, t'i zhubrosin/grisin etj). <b>Aktivitet:</b> Të shfletojmë një libër. <b>Vjersha:</b> “Jam një vajzë simpatike”.	Manuali i Vjershave Gazeta, libra etj
E Mërkurë	<b>Veshja për djemtë</b>	<b>Aktivitet:</b> Demonstroni fëmijëve veshjet e djemve, emërtojini ato si bluzë, xhaketë, pantallona etj. Tregoni ngjyrat e veshjeve. <b>Lojame pasqyrë:</b> “ Vendosni fëmijët përpara një pasqyre. Vëreni reagimin e tij. Më pas tregoni kush është në pasqyrë. Tregoni me gisht veshjet e tij. <b>Loja :</b> Loja me flluska sapuni. <b>Këngë dhe muzikë</b> (me zgjedhje).	

<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Pasqyrimi im.</b></p> 	<p><b>Aktivitet :</b> Vendosni përpara fëmijës një pasqyrë më të madhe se fëmija. Vëreni reagimin e tij. Më pas tregoni kush është në pasqyrë. Emërtoni pjesët e fytyrës duke i treguar ato te pasqyrimi i fëmijës.</p> <p><b>Imitime :</b> Gjatë aktivitetit përballë pasqyrës bëni disa reagime me fytyrë si : shkel syrit, bëj si i mërzhitur etj, shikoni nëse edhe fëmija po perpiqet t’ju imitoj. Ngrini duart lart, hidhuni etj.</p> <p><b>Këngë :</b> ‘Rosat po lahen në liqen’.</p>	<p>Manuali i Vjershave Pasqyrë</p>
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Lojra dhe aktivitete</b></p>	<p><b>Vjersha:</b> “Xhepi im i vogël”.</p> <p><b>Loja:</b> Gjejmë objektin e fshehur. Tregojini fëmijës një objekt dhe më pas fshiheni atë posht një batanijeje ose çarçafi (sigurohuni që fëmijët t’ju shikojnë). Më pas thoni “ku shkoi lodra?”, Vëreni nëse fëmijët arrijnë ta gjejnë atë.</p> <p><b>Lojë ndijore:</b> Lojë duke përdorur materiale të ndryshme të veshjeve .</p> <p><b>Kënga:</b> “Ylli i vogël”.</p>	<p>Manuali i Vjershave</p>